


Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 11.08.2015, mori:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me nr. AKK-03-02-1790/15, për z. Reshit Qafleshi, Drejtor i Drejtorisë së Shëndetësisë dhe mirëqenies Sociale në Komunën e Dragashit, për shkak se nuk ka të dhëna të mjaftueshme që argumentojnë dyshimin e arsyeshëm për ekzistimin e konfliktit të interesit.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

Rasti i hapur nën dyshimin për Konflikt Interesi në Ushtrimin e Funkcionit Publik për zyrtarin e lartë, z. Reshit Qafleshi, Drejtor i Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, i cili është dyshuar se ka punësuar djalin e tij në kuadër të kësaj Drejtorie në pozitën e punës Zyrtar i Ndhimave Sociale në Qendrën për Punë Sociale të Komunës së Dragashit.

Zyrtari i lartë, fillimisht është njoftuar me një shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korrupsionit, për fillimin e shqyrtimit të gjendjes së mundshme të konfliktit të interesit, Pas pranimi të kësaj shkrese, kemi organizuar një takim me zyrtarin e lartë, gjatë këtij takimi z. Qafleshi është njoftuar me pretendimet e palës së tretë se ka punësuar djalin e tij në kuadër të Drejtorisë ku edhe e ushtron funksionin publik.

Zyrtari i lartë z. Reshit Qafleshi ka pranuar se pas një konkursi publik z. Dashnor Qafleshi ka aplikuar për punë në pozitën Zyrtar i Ndhimave Sociale në Qendrën për Punë Sociale të Komunës së Dragashit, pas kësaj z. Dashnor Qafleshi është përzgjedhur nga komisioni për

zhvillim të procedurës së rekrutimit si kandidat me rezultatin më të mirë. Ndërkohë konkursi është anuluar nga komisioni për konteste dhe ankesa i Komunës së Dragashit për shkak të shkeljeve procedurale.

Bazuar në këto rrethana vlerësojmë se nuk ka konflikt interesit z. Dashnor Qafleshi nuk ka themeluar mardhënie të punës në Pozitën Zyrtar i Ndihmave Sociale në Qendrën për Punë Sociale të Komunës së Dragashit.

Zyrtari i lartë z. Qafleshi është i obliguar që gjatë ushtrimit të funksionit publik të bëjë deklarin rast për rast të interesave private lidhur me një vendimmarrje të caktuar neni 13 (paragrafi 1,2,3) të Ligjit nr. 04/L-051.

II. Në mbështetje të nenit 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Hasan Preteni
Drejtore i Agjencisë kundër Korrupsionit

